




# UDHËRRËFYES

## NË MBËSHTETJE TË ZBATIMIT TË PLANEVE TË SIGURISË SË UJIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

# UDHËRRËFYES

## NË MBËSHTETJE TË ZBATIMIT TË PLANEVE TË SIGURISË SË UJIT



## **GRUPI I PUNËS:**

**Zhaneta Miska** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
**Besiana Llazani** Ministria e Transportit dhe Energjisë  
**Afërdita Mamaj** Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve  
**Gazmend Bejtja** Zyra e OBSH-së për Shqipërinë  
**Monika Vejseli** GIZ

# PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| HYRJA .....   | 5  |
| 1. Kuptimi dhe vlerësimi i përfitimeve të një qasjeje PSU .....                     | 6  |
| 2. Krijimi i vizionit paraprak të PSU-së .....                                      | 7  |
| 3. Marrja e eksperiencës praktike për PSU-në .....                                  | 8  |
| 4. Përfshirja e PSU-së në dokumentet strategjike respektive .....                   | 10 |
| 5. Krijimi i mekanizmave për mbështetjen e vazhdueshme të PSU-së .....              | 11 |
| 6. Përgatitja e instrumenteve politike dhe rregullatore për zbatimin e PSU-së ..... | 12 |
| 7. Zbatimi i PSU-së dhe verifikimi i efektivitetit të tij .....                     | 13 |
| 8. Shqyrtimi i eksperiencave të përgjithshme PSU dhe shkëmbimi i eksperiencës ..... | 14 |

## **HYRJE**

Ky udhërrëfyes jep udhëzime se si të prezantohet dhe shtrihet zbatimi i Planeve të Sigurisë së Ujërave (PSU). Ai është përshtatje e udhërrëfyesit të OBSH-së dhe IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit) “A road map to support country-level implementation of water safety plans” dhe është përgatitur si pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e ujit të pijshëm.

Udhërrëfyesi i adresohet institucioneve qendrore, vendore dhe rregullatore që kanë për detyrë të rishikojnë ose të zhvillojnë politikën, programet dhe rregulloret e reja të cilësisë së ujit të pijshëm. Gjithashtu mund të jetë i dobishëm për organizatat jofitimprurëse, agjencitë financuese dhe organizatat e tjera të interesuara për përmirësimin e programeve dhe praktikave ekzistuese.

Për qartësi, hapat janë paraqitur në një mënyrë të thjeshtuar. Në varësi të kontekstit lokal dhe të autoritetit udhëheqës për zbatimin e tyre, këto hapa nuk duhet domosdoshmërisht të ndiqen në rendin e dhënë.

### **PSU-të mund të prezantohen me mjete dhe mënyra të ndryshme, duke përfshirë:**

- Një akt nënligjor detyrues për zbatimin e PSU-së nga administratorët e shërbimit të furnizimit me ujë, si një mjet për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin publik;
- Zbatimin pro-aktiv të PSU-ve nga administratorët e shërbimit të furnizimit me ujë për të përmirësuar performancën, cilësinë e ujit të pijshëm, pajtueshmërinë ose kujdesin e duhur;
- Kërkesat drejtuar donatorëve nga agjencitë e zbatimit të projekteve për të siguruar që ecuria e projekteve të jetë në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare; dhe/ose
- Nxitja ose mbështetja nga shoqatat e ujit, mbrojtjes së konsumatorit dhe shoqatat e industrisë, për të inkurajuar zbatimin në nivel furnizimi individual të ujit dhe në nivel sektori.

### **PSU-të zbatohen më efektivisht përmes veprimeve të bashkërenduara të të gjithë aktorëve të përfshirë në furnizimin me ujë të pijshëm. Udhëzimet e OBSH-së rekomandojnë që:**

- Pushteti qendror dhe ai vendor të hartojnë politika, rregullore dhe mjete të përshtatshme për të inkurajuar dhe mbështetur zbatimin e PSU-së;
- Administratorët e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm të zbatojnë PSU-të; dhe
- Institucionet përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm të mbështesin dhe të auditojnë PSU-të.

Udhëzimet e OBSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm i rekomandojnë PSU-të si mjetin më efektiv për të siguruar vazhdimisht një furnizim të sigurt me ujë të pijshëm. PSU-të kërkojnë një vlerësim të rrezikut që përfshin të gjitha hapat e furnizimit me ujë, nga burimi tek konsumatori, ndjekur nga zbatimi dhe monitorimi i masave të kontrollit të menaxhimit të rrezikut. PSU-të duhet të zbatohen brenda kontekstit të shëndetit publik, duke iu përgjigjur objektivave të qarta shëndetësore dhe cilësisë së kontrolluar përmes mbikëqyrjes së pavarur.

# 1. KUPTIMI DHE VLERËSIMI I PËRFITIMEVE TË NJË QASJEJE PSU

**Objektivi:** Përfaqësuesit e aktorëve kryesorë në sektorin e shëndetit publik dhe të furnizimit me ujë të jenë të familjarizuar me qasjen PSU dhe ta përkrahin atë.

**Rezultati:** Është arritur niveli fillestar i interesit dhe mirëkuptimit për PSU-të nga përfaqësuesit e aktorëve kryesorë.

## Ç'duhet të dimë rreth PSU-ve

Përfaqësuesit e sektorit të furnizimit me ujë dhe të shëndetit publik mund të njihen me qasjen PSU, përfitimet dhe zbatimin e saj në udhëzuesin e menaxhimit hap-pas-hapi të rrezikut për sistemet e vegjël të furnizimit me ujë “Planet e Sigurisë së Ujit për Sistemet e Vegjël të Furnizimit me Ujë”<sup>1</sup>, i cili do të ndiqet nga udhëzuesi i Planeve të Sigurisë së Ujit për sistemet urbane të furnizimit me ujë dhe dokumente mbështetëse të mundshme. Informacion i mëtejshëm mund të gjendet në Udhëzimet e OBSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm<sup>2</sup>, të cilat rekomandojnë PSU-në si qasjen e preferuar për menaxhimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Mekanizma të tjerë për të mësuar më shumë rreth qasjes PSU përfshijnë pjesëmarrjen në konferenca ose seminare kombëtare/rajonale/ndërkombëtare dhe duke organizuar aktivitete kombëtare të mbështetura nga OBSH, GIZ etj.

Me qëllim nxitjen e interesit për PSU-të, është i rëndësishëm komunikimi i përfitimeve të qasjes PSU tek palët relevante kombëtare, duke përfshirë përfitimin e përgjithshëm lidhur me përmirësimin e cilësisë së ujit dhe për rrjedhim, me mbrojtjen më të mirë të shëndetit publik. Përfitime të tjera përfshijnë, për shembull, një kuptim më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë, administrim me efikasitet më të lartë, përmirësim të performancës së shërbimeve, marrëdhënie të përmirësuara mes aktorëve dhe përdorim të fokusuar të burimeve financiare. Informacione të mëtejshme mund të gjenden në PortalSU<sup>3</sup>.

Ndër rrjetet mbështetëse të PSU-ve janë:

- Grupi Specialist IWA për Planet e Sigurisë së Ujit<sup>4</sup>
- Rrjeti Ndërkombëtar i OBSH-së i Rregullatorëve të Ujit të Pijshëm<sup>5</sup>
- Rrjeti Ndërkombëtar i OBSH-së i Menaxhimit të Sistemeve të Vegjël të Furnizimit me Ujë<sup>6</sup>

1 <http://www.shendetesia.gov.al>; <http://www.infrastruktura.gov.al>;

2 [http://www.who.int/water\\_sanitation\\_health/dwq/gdwq3rev/en/index.html](http://www.who.int/water_sanitation_health/dwq/gdwq3rev/en/index.html)

3 <http://www.wsportal.org>

4 [http://www.iwahq.org/Home/Networks/Specialist\\_groups/List\\_of\\_groups/](http://www.iwahq.org/Home/Networks/Specialist_groups/List_of_groups/)

5 Duhet patur parasysh se pjesëmarrja është e kufizuar për përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për rregullimin e prodhimit, cilësisë dhe mbikëqyrjes së pavarur të ujit të pijshëm. Kontakto [RegNet@who.int](mailto:RegNet@who.int)

6 [http://www.who.int/water\\_sanitation\\_health/dwq/scwsm\\_network/en/index.html](http://www.who.int/water_sanitation_health/dwq/scwsm_network/en/index.html)

## **Krijimi i marrëdhënieve bashkëpunuese**

Është e rëndësishme të identifikohen individët dhe institucionet kryesore që do të mbështesin dhe ndajnë përgjegjësinë për promovimin e PSU-ve dhe të arrihet dakordësia e tyre. Këta mund të përfshijnë përfaqësues të lartë nga institucionet përgjegjëse për shëndetin publik dhe ujin e pijshëm (për shembull, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), administratorët e shërbimit të furnizimit me ujë, përfaqësues të shoqatave kombëtare të furnizimit me ujë, përfaqësues të komunitetit ose pushtetit lokal etj. Mundësisht, këto palë të organizohen në një grup ndërinstitucional pune.

## **Dakordësimi për të shqyrtuar qasjen PSU**

Pas kësaj, qeveria dhe palët e tjera të interesit mund të bien dakord për të shqyrtuar PSU-në si qasjen e preferuar për menaxhimin e qëndrueshëm të sigurisë së ujit të pijshëm. Mund të jetë i dobishëm konsultimi me ekspertë nga vende të tjera me eksperiencë në zbatimin e PSU-së për tu informuar më mirë mbi hapat që duhen ndërmarrë.

## **2. KRIJIMI I VIZIONIT PARAPRAK TË PSU-SË**

***Objektivi:** Ngritja e një grupi ndërinstitucional pune për PSU-në dhe vizioni i dakordësuar për përmirësimin e menaxhimit të cilësisë së ujit të pijshëm përmes përdorimit të PSU-ve.*

***Rezultati:** Është arritur angazhimi fillestar i qeverisë për të promovuar dhe ndjekur në mënyrë aktive zbatimin e PSU-ve.*

## **Krijimi i një grupi ndërinstitucional pune**

Roli i grupit ndërinstitucional të punës përfshin zhvillimin e vizionit kombëtar për PSU-në si dhe mbikëqyrjen dhe dhënien e udhëzimeve për zbatimin e saj. Ky grup pune duhet të përbëhet nga përfaqësues të sektorit të shëndetësisë dhe atij të furnizimit me ujë, duke përfshirë personat me përgjegjësi për furnizimin me ujë, menaxhimin e cilësisë së ujit dhe hartimin dhe zbatimin e akteve/nënakteve ligjore për ujin e pijshëm. Grupit të punës i nevojitet udhëheqje e fortë, burime të duhura njerëzore dhe financiare, takime dhe komunikime të rregullta midis anëtarëve dhe mbështetje politike. Nëse është e mundur, duhet të jetë zyrtarisht i miratuar.

## **Vizioni fillestar PSU**

Bazuar në një vlerësim të akteve/nënakteve ligjore ekzistuese për ujin e pijshëm dhe në përfitimet e perceptuara të PSU-ve, grupi i punës duhet të koordinojë hartimin e një vizioni fillestar të PSU-së. Ky vizion mund të përshkruajë ose qëllimin përfundimtar që të gjithë administratorët e shërbimit të furnizimit me ujë të zhvillojnë dhe zbatojnë PSU-të ose thjesht mund të kërkojë dhe inkurajojë adoptimin e qasjeve parandaluese të menaxhimit të rrezikut.

Përveç kësaj, për të promovuar dhe arritur vizionin e PSU-së, duhet të identifikohen dhe të kontaktohen palët e interesit si nga institucionet qeveritare ashtu edhe nga ato joqeveritare.

### 3. MARRJA E EKSPERIENCËS PRAKTIKE PËR PSU-NË

**Objektivi:** *Projekte demonstrimi të PSU-së të zbatuara me një ose më shumë administratorë të shërbimit të furnizimit me ujë në bashkëpunim me AKUK dhe palë të tjera potenciale të interesit.*

**Rezultati:** *Është përftuar eksperiencë praktike për hartimin dhe zbatimin e PSU-së në një kontekst lokal.*

#### **Zbatimi i projektit demonstrues të PSU-së**

Grupi ndërinstitucional i punës do të duhet të mbikëqyrë hartimin dhe zbatimin e një ose disa projekteve demonstruese të PSU-së në bashkëpunim me një ose më shumë administratorë të shërbimit të furnizimit me ujë për të vazhduar më tej me vizionin e PSU-së. Qëllimi i pilotimit është të demonstrojë se PSU mund të zbatohet me sukses, të sigurojë një model lokal dhe të hedhë bazat për krijimin e një ekipi të ekspertëve kombëtarë për PSU-në. Prandaj, kur zgjidhet administratori i shërbimit të furnizimit me ujë për projektin demonstrues, është e rëndësishme të merret në konsideratë performanca e tij dhe interesi për t'u angazhuar në qasjen PSU. Është e dobishme që projekti demonstrues i PSU-së të fokusohet në arritjen e "fitoreve të shpejta", aty ku zbatimi i një PSU-je ka potencialin për të përmirësuar një problem specifik që lidhet me cilësinë e ujit të pijshëm. Nëse kërkohet mbështetje teknike e jashtme, mund të kërkohet shërbimi i një eksperti vendor ose ndërkombëtar, përfshirë nga OBSH, IWA, universitete ose organizata të tjera të përfshira në mbështetjen e PSU-së.

Grupi ndërinstitucional i punës është gjithashtu përgjegjës për të siguruar që ekipi PSU dhe administratori i shërbimit të furnizimit me ujë të kenë burime të mjaftueshme (njerëzore, njohurish apo financiare) për zbatimin me sukses të projektit demonstrues.

#### **Vlerësimi i projektit demonstrues të PSU-së**

Pilotimi duhet të vlerësohet nga ekipi PSU dhe grupi ndërinstitucional i punës kundrejt kriterëve të mëposhtme, për të vijuar me vizionin dhe përfshirjen e PSU-së në dokumentet strategjike respektive për zbatimin në shkallë të gjerë të saj:

- Fizibiliteti në kontekstin kombëtar dhe lokal lidhur me burimet ekzistuese;
- Vlera e shtuar e afërt dhe ajo e pritshme për konsumatorët, administratorët e shërbimit të furnizimit me ujë dhe palët e tjera të interesit lidhur me cilësinë e ujit të pijshëm dhe shëndetin;
- Burimet e nevojshme (përfshirë ato njerëzore, njohuritë, materialet dhe mjetet mbështetëse, kohën, buxhetin dhe pajisjet);
- Sfidat e hasuara gjatë zbatimit dhe si u adresuan ato;
- Dallimet ndërmjet praktikave aktuale dhe atyre që kërkohen për zbatimin e PSU-së në administrim dhe menaxhim; dhe
- Mësime të tjera të nxjerra.



## HAPAT E PROJEKTIT TË DEMONSTRIMIT

### Faza 1: Planifikimi

- Përcaktimi i aktorëve përgjegjës për projektin e demonstrimit dhe sigurimi i angazhimit të tyre me grupin ndërinstitucional të punës.
- Zgjedhja e administratorit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm ku do të zbatohet demonstrimi.
- Zgjedhja e anëtarëve të ekipit PSU përgjegjës për të hartuar dhe ndjekur zbatimin e PSU-së (referuar Udhëzuesit për Planet e Sigurisë së Ujit<sup>7</sup>).
- Hartimi i një plan-veprimi realist dhe të arritshëm për zbatimin e PSU-së, duke përfshirë objektivat, afatet kohore, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit PSU, buxhetin dhe mekanizmat e raportimit tek grupi ndërinstitucional i punës.
- Trainimi i ekipit PSU mbi procesin e PSU-ve. Nëse është e nevojshme, mund të thirret një ekspert i jashtëm për të ofruar trajnime dhe këshilla teknike gjatë gjithë projektit të demonstrimit.

### Faza 2: Zbatimi

- Hartimi dhe ndjekja e zbatimit të PSU-së nga ekipi PSU sipas Planit të Veprimit.
- Raportimi i rregullt në grupin ndërinstitucional të punës nga ekipi PSU për ecurinë e zbatimit të PSU-së.
- Sigurimi i trajnimit të mëtejshëm sipas nevojës të ekipit PSU dhe stafit administrativ në fazat e ardhshme të zbatimit të PSU-së dhe ndryshimi i planit të veprimit nëse është i nevojshëm.
- Plotësimi i ciklit të parë të PSU-së.

### Faza 3: Finalizimi

- Organizimi i një rishikimi të jashtëm të PSU-së dhe i rishikimit bazuar në reagimet e palëve të interesit.
- Vlerësimi i rezultateve të PSU-së nga grupi ndërinstitucional i punës dhe ekipi PSU.
- Komunikimi me aktorët kombëtarë dhe donatorët si dhe shpërndarja ndërmejt tyre e rezultateve të projektit të demonstrimit të PSU-së.

---

<sup>7</sup> <http://www.shendetesia.gov.al>; <http://www.infrastruktura.gov.al>;

## 4. PËRFSHIRJA E PSU-SË NË DOKUMENTET STRATEGJIKE RESPEKTIVE

**Objektivi:** Organizimi i një procesi konsultimi me shumë palë të interesit për të rishikuar dhe përmirësuar vizionin fillestar dhe për të përfshirë PSU-në në dokumentet strategjike respektive për zbatimin në shkallë të gjerë të saj.

**Rezultati:** PSU është përfshirë në dokumentet strategjike respektive dhe është hartuar nga palët kryesore të interesit Plani i Veprimit për zbatimin e saj.

### Zhvillimi i Planit të Veprimit për zbatimin e PSU-së

Bazuar në eksperiencën e fituar nga projekti demonstrues, grupi ndërinstucional i punës duhet të rivlerësojë vizionin fillestar të PSU-së dhe të zhvillojë një plan veprimi të detajuar për të arritjen e tij. Kjo do të kërkojë mbështetjen e nevojshme të qeverisë për zbatimin e PSU-ve dhe konfirmimin e burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për të kryer këtë punë (duke përfshirë mobilizimin e fondeve të jashtme, nëse është e nevojshme). Pikat kyçe për t'u marrë në konsideratë ose për tu përfshirë në Planin e Veprimit janë si më poshtë:

- *Rishikimi i akteve/nënakteve ligjore ekzistuese të cilësisë së ujit* për të vlerësuar pikat e forta dhe dobësitë e kuadrit ekzistues për të parë se si qasja PSU mund ta plotësojë dhe përmirësojë atë. Ky vlerësim mund të ketë filluar kur u hartua vizioni fillestar i PSU-së dhe mund të përdoret informacioni i mbledhur në atë kohë.
- *Rishikimi i roleve, përgjegjësive dhe aftësive të institucioneve përkatëse*, duke përfshirë efektivitetin e strukturave aktuale të punës. Për më tepër, duhet të identifikohen rolet dhe përgjegjësitë institucionale që nevojiten për adoptimin e suksesshëm dhe të qëndrueshëm të qasjes PSU. Detaje të mëtejshme përshkruhen në seksionin 6.
- *Përshkrimi i qëllimit dhe objektivave të PSU-së dhe arsytimi për to*. Grupi ndërinstucional i punës duhet të kuptojë implikimet e akteve/nënakteve ligjore që po shqyrtohen. Për shembull, nëse zbatimi i PSU-së bëhet një kërkesë e detyrueshme, pritët që administratori i shërbimit të furnizimit me ujë do të duhet të ketë aftësinë për të zbatuar PSU-në. Në të njëjtën kohë, vetë administratorët e ujit mund të kenë nevojë për mbështetje, dhe ndoshta stimulime, para se të angazhohen në qasjen PSU. Nga ana tjetër, nëse zbatimi i PSU-së nuk është bërë një kërkesë e detyrueshme, disa administratorë të ujit mund të hezitojnë të miratojnë qasjen PSU. Grupi i punës duhet të identifikojë objektivat e zbatimit dhe datat e parashikuara të arritjes së tyre për të monitoruar progresin.
- *Identifikimi i palëve potenciale kombëtare dhe ndërkombëtare të interesit për PSU-në dhe rolet e tyre për zbatimin e Planit të Veprimit*. Është e rëndësishme të angazhohet një grup i gjerë palësh interesi, duke marrë parasysh të gjitha palët e përfshira në fushat e ujit, kanalizimeve dhe shëndetit publik.
- *Përshkrimi i mekanizmave dhe instrumenteve të politikave për të mbështetur zbatimin e PSU-së*. Kjo duhet të përfshijë aktivitete për përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të adresuara tek administratorët e ujit dhe palët e tjera. Detajet e mëtejshme të këtyre aktiviteteve mbështetëse janë përshkruar në seksionet 5 dhe 6.

## **Nxitja e dakordësisë me shumë palë të interesit**

Grupi ndërinstitucional i punës dhe furnizuesit e ujit të përfshirë në projektin demonstrues për PSU-në duhet të organizojnë një seminar për të marrë reagime dhe për të kërkuar mbështetjen e Planit të Veprimit nga një grup i gjerë aktorësh të cilët nuk ishin përfshirë në iniciativat e mëparshme të PSU-së. Gjatë këtij seminari, procesi dhe rezultatet e projektit demonstrues duhet të prezantohen me fokus në nxjerrjen në pah të afateve kohore, përfitimeve, sfidave dhe mundësive për zbatimin e gjerë të PSU-së. Duhet të kërkohej një angazhim i fortë nga të gjithë aktorët që të punojnë së bashku në shtrirjen e zbatimit të PSU-së.

## **5. KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR MBËSHTETJEN E VAZHDUESHME TË PSU-VE**

***Objekti:** Programe afatgjata të krijuara për të ngritur dhe përmirësuar kapacitetin e administratorëve të ujit dhe palëve të tjera të interesit.*

***Rezultati:** Është krijuar mjedis i përshtatshëm dhe mekanizmat e duhur për të mbështetur zbatimin e PSU-së.*

### **Përkrahja e vazhdueshme për PSU-të**

Për të mbështetur zbatimin e gjerë të PSU-ve, përkrahja duhet të shtrihet në një shkallë më të gjerë. Duhet të përgatiten materiale specifike dhe të organizohen aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin midis të gjithë palëve të interesit duke përfshirë edhe konsumatorët (shih seksionin 4). Kjo përfshin organizatat që mund të financojnë programet e përmirësimit (p.sh. infrastrukturë, pajisje, trajnim etj.) që do të identifikohen përmes procesit PSU. Duhet të identifikohen "kampionët e PSU-së" midis palëve të ndryshme të interesit dhe të mbështeten në përpjekjet e tyre për të promovuar PSU-të. Për më tepër, grupi ndërinstitucional i punës, AKUK dhe ata që janë përfshirë në projektin demonstrues të PSU-së duhet të promovojnë qasjen PSU.

### **Shkallëzimi i trajnimit mbi PSU-në**

Trajnimi mbi PSU-në përfshin jo vetëm instruksionet praktike se si të hartohet një PSU, por gjithashtu edhe trajnimin e fokusuar në aspekte të veçanta të çështjeve të menaxhimit të cilësisë së ujit të pijshëm. Ai gjithashtu përfshin trajnimin e institucioneve përkatëse mbi mënyrën e rishikimit dhe auditimit të PSU-ve. Eksperienca lokale e fituar përmes projekteve demonstruese të PSU-së duhet të shpërndahet, nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet kolegëve (shih paragrafin në vijim). Gjithashtu, duhet të merren parasysh ngritja e kapaciteteve të shoqatave kombëtare të furnizimit me ujë dhe ofruesve të trajnimeve në sektorin e ujit dhe shëndetit publik për të ofruar trajnime mbi PSU-në. Me përmirësimin në mënyrë progresive të programeve, mund të futen edhe trajnimi dhe edukimi i certifikuar. Së fundi, duhet gjithashtu të hulumtohet dhe inkurajohet përfshirja e PSU-ve në kurrikulën universitare dhe programet e vazhdueshme të arsimit dhe formimit profesional.

## **Krijimi i partneriteteve shërbim - shërbim**

Partneritetet mund të forcojnë mbështetjen e stafit ndërmjet shoqërive të furnizimit me ujë. Një furnizues i përgatitur për PSU-të mund të luajë një rol udhërrëfyes për ata furnizues që po iniciojnë hartimin e PSU-së, ndërsa partneritetet midis dy furnizuesve të të njëjtit nivel do të ndihmonin shkëmbimin e njohurive. Partneritetet mund të formohen midis ekipit PSU nga projekti demonstrues dhe furnizuesve të tjerë brenda vendit ose midis një furnizuesi brenda vendit dhe një furnizuesi nga jashtë me eksperiencë mbi PSU-në. Partneritetet gjithashtu mund të formohen midis furnizuesve që janë në procesin e zbatimit të PSU-së brenda një rajoni gjeografik, për të punuar së bashku në disa aspekte të PSU-së, për shembull, në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve dhe në zhvillimin e masave lehtësuese. Mundësi të tilla mund të lehtësohen përmes iniciativës së Partneritetit të Administratorëve të Ujit (WOPs)<sup>8</sup>.

## **Zhvillimi dhe shpërndarja e mjeteve dhe burimeve**

Në mbështetje të zbatimit të PSU-së janë hartuar një numër dokumentesh ndërkombëtare duke përfshirë Manualin e PSU-së dhe WSPortal. Në rastin e përgatitjes së një materiali sipas kushteve lokale, është shumë i rëndësishëm standardizimi i formatit për të siguruar përfshirjen e hapave kryesorë të PSU-së, por duhet të ketë fleksibilitet të mjaftueshëm për të siguruar që kushtet lokale dhe rreziqet, të cilat mund të ndryshojnë nga një vend në tjetrin, adresohen në mënyrën e duhur. Mund të fuqizohen qendrat kombëtare ose rajonale të burimeve për të ofruar këshilla teknike dhe mbështetje të vazhdueshme në hartimin dhe zbatimin e PSU-ve. Gjithashtu, duhet të identifikohen boshllëqet e njohurive dhe të zhvillohet e koordinohet një axhendë kërkimore e priorizuar midis universiteteve dhe qendrave kërkimore.

## **6. PËRGATITJA E AKTEVE/NËNAKTEVE LIGJORE PËR ZBATIMIN E PSU-SË**

***Objektivi:** Përfshirja formale e qasjes PSU në aktet/nënaktet ligjore përkatëse.*

***Rezultati:** Janë krijuar kuadri institucional funksional dhe instrumentet ligjore dhe financiare, që nxisin dhe mbështesin zbatimin e PSU-së.*

### **Fuqizimi i institucioneve**

Zbatimi i PSU-së kërkon një kuadër institucional me një përcaktim të qartë dhe kuptim të ndërsjellë të roleve dhe përgjegjësive. Institucionet duhet të fuqizohen për të ndërmarrë përgjegjësitë e tyre, përkatësisht shpërndarjen e personelit të duhur (duke përfshirë nivelin e njohurive), burimet teknike dhe financiare. Kjo përfshin aftësimin e autoriteteve përkatëse qeveritare për të kuptuar dhe luajtur një "rol të ri" në mbështetjen dhe auditimin e PSU-ve.

<sup>8</sup> [www.unhabitat.org/content.asp?cid=5907&catid=568&typeid=24&subMenuId=0](http://www.unhabitat.org/content.asp?cid=5907&catid=568&typeid=24&subMenuId=0).

## **Hartimi i akteve/nënakteve ligjore**

Përfshirja e zbatimit të PSU-së si një kërkesë ligjore mund të sigurojë një shtysë për zbatimin e gjerë të PSU-ve dhe të sigurojë një kuadër të fuqishëm për ruajtjen efektive të cilësisë së ujit të pijshëm në afat të gjatë. Megjithatë, instrumentet ligjore duhet të përdoren vetëm kur ekzistojnë mekanizmat për mbështetjen e vazhdueshme të zbatimit të PSU-së, kështu furnizuesit e ujit kanë kapacitetin për të përmbushur detyrimet e tyre ligjore dhe qeveria ka aftësinë për t'i zbatuar ato. Këshillohet përfshirja graduale e PSU-ve në kuadrin ligjor. Kjo mund të fillojë me një dokument politikash të përbashkët të MIE dhe MSHMS), duke inkurajuar fuqimisht zbatimin e PSU-së. Opsione të tjera përfshijnë akte/nënakte ligjore me afate të përcaktuara qartë për zbatimin e PSU-së për madhësi të ndryshme të administratorëve të shërbimit të furnizimit dhe akte/nënakte ligjore që kërkojnë që administratorët e shërbimit të kenë një PSU, me një plan përmirësimi gradual me afatet kohore dhe burimet respektive.

Në hartimin e akteve/nënakteve ligjore për PSU-të, vëmendje e veçantë duhet t'u jepet sistemeve të vegjël të furnizimit me ujë pasi këto furnizime në përgjithësi paraqesin një rrezik më të madh për shëndetin publik në krahasim me sistemet e mëdhenj të furnizimit. Gjithashtu, sistemet e vegjël të furnizimit me ujë shpesh kanë nevojë për kohë dhe burime shtesë për të zbatuar PSU-të.

## **Sigurimi i instrumenteve financiare**

Zbatimi i PSU-ve mund të ketë kosto të vogla, kryesisht për financimin e trajnimeve, konsultimeve të jashtme ose stafit shtesë. Zbatimi i PSU-së do të identifikojë nevojat për investime afatshkurtra dhe afatgjata për të përmirësuar cilësinë e ujit të pijshëm. Prandaj është e rëndësishme që të vihet në dispozicion financimi për të mbështetur zbatimin e PSU-së si dhe përmirësimet e identifikuara përmes zbatimit të saj. Financimi mund të sigurohet nga qeveria, pushteti vendor, administratorët, agjencitë zbatuese dhe donatorët, institucionet ndërkombëtare financiare dhe/ose përmes investimeve private.

## **7. ZBATIMI I PSU-VE DHE VERIFIKIMI I EFEKTIVITETIT TË TYRE**

***Objektivi:** Furnizuesit e ujit të zbatojnë PSU-të të cilat i nënshtrohen rregullisht auditimit dhe monitorimit të pajtueshmërisë.*

***Rezultati:** Janë zbatuar praktikat e menaxhimit të rrezikut me konfirmimin që PSU-të janë zhvilluar në mënyrën e duhur.*

## **Vazhdimi i zbatimit të PSU-ve**

Furnizuesit e ujit dhe ekipet PSU do të kenë nevojë për udhëzime dhe mbështetje kohë pas kohe gjatë hartimit, zbatimit dhe rishikimit periodik të PSU-ve të tyre. Prandaj, aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve, të tilla si trajnimi dhe nëse është e mundur, partneritetet shërbim - shërbim, duhet të zhvillohen paralelisht me zbatimin e PSU-së. Gjithashtu mund të krijohen mekanizma të veçantë për të siguruar mbështetje të vazhdueshme për të lehtësuar zbatimin, si p.sh. qendra informacioni ose shërbime këshilluese mbi PSU-në.

## **Verifikimi që PSU-të janë të përshtatshme**

PSU-të duhet të auditohen në mënyrë të pavarur për të siguruar që ato funksionojnë siç duhet. Duhet të zhvillohet një plan auditimi që përfshin kohën dhe shpeshtësinë e auditimeve, fushën e auditimit dhe kriteret e vlerësimit dhe raportimit. Gjithashtu duhet të jenë përgatitur procedurat, duke specifikuar veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, për rastet kur PSU-të nuk janë vlerësuar si të përshtatshme. Kurdo që është e mundur, në përgjithësi dhe sigurisht në fazat e hershme të zbatimit të PSU-së, auditimet duhet të trajtohen si mundësi për mësim dhe përmirësim më shumë sesa për vendosjen e gjobave.

## **8. SHQYRTIMI I EKSPERIENCAVE TË PËRGJITHSHME MBI PSU-NË DHE SHKËMBIMI I MËSIMEVE TË NXJERRA**

*Objektivi: Progres raporti për zbatimin e PSU-së në të gjithë vendin duke cituar përmirësimet, sfidat dhe rezultatet e cilësisë së ujit të pijshëm.*

*Rezultati: Janë arritur përmirësime afatgjata dhe të qëndrueshme në menaxhimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe në cilësinë e ujit të pijshëm.*

### **Rishikimi i vazhdueshëm i zbatimit të PSU-së**

PSU-të janë menduar të jenë një proces i vazhdueshëm i menaxhimit dhe përmirësimit të furnizimit me ujë.

Prandaj, përparimi në zbatimin e PSU-së duhet të rishikohet vazhdimisht. Në nivel kombëtar, kjo duhet të përfshijë, për shembull, identifikimin e përmirësimeve në aspektin e shëndetit publik, pajtueshmërinë me kërkesat e cilësisë së ujit të pijshëm dhe kujdesin e përgjithshëm të furnizuesve të ujit. Duhet gjithashtu të identifikohen dhe adresohen mangësitë në zbatim, të cilat lidhen me studimet kërkimore dhe rreziqet e reja, kapacitetet dhe nevojat financiare.

### **Shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencës**

Për të lehtësuar përparimin në zbatimin e PSU-së në nivel kombëtar, është e rëndësishme që mësimet e nxjerra të shkëmbehen ndërmjet palëve të interesit. Gjithashtu, përmirësimet e përfutuara mund të komunikohen me publikun. Për të ndihmuar progresin global, është gjithashtu i rëndësishëm informimi i komunitetin rajonal dhe ndërkombëtar për eksperiencat brenda vendit. Për lehtësimin e këtij informimi mund të ndihmojë shkëmbimi me OBSH-në dhe IWA-n përmes WSPortal, publikimi i dokumenteve, pjesëmarrja në konferenca dhe partneritetet formale dypalëshe midis vendeve.